

VENDIM
Nr. 509, datë 30.7.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 35, DATË 29.1.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME
KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2014, NË NJËSITË E QEVERISJES
QENDRORE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 35, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2014, në njësitë e qeverisjes qendrore është 887 veta, sipas lidhjeve nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5 e nr. 6, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij."

b) Pas lidhjes nr. 5 shtohet lidhja nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cila detajon ndarjen e shtesës prej 22 punonjësish, të miratuar me këtë vendim.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga fondet buxhetore të institucioneve të përmendura në këtë vendim.

3. Ngarkohen institucionet e përmendura në këtë vendim të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme brenda numrit të përcaktuar në lidhjen nr. 6, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe brenda kriterëve të vendimit nr. 1703, datë 24.12.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja
nr.6

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
6	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	1			
	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës-Kanalizimeve	1	Arkivist protokollist	6 orë ditë	01.07.2014-31.12.2014
10	Ministria e Financave	4			
	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave	4	Specialist	8 orë ditë	01.08.2014-31.12.2014
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	3			
	Agjencia Telegrafike Shqiptare	3	Specialist	8 orë ditë	01.08.2014-31.12.2014
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	2			
	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	2	Specialist	8 orë ditë	01.08.2014-31.12.2014
87	Institucione të tjera qeveritare	1			
	Inspektorati Qendror	1	Punonjës mirëmbajtjeje	6 orë ditë	15.07.2014-31.12.2014
94	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	11			
	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	9	Specialist	8 orë ditë	15.07.2014-15.9.2014
	Zyra e Shërbimit Turistik	2	Specialist	8 orë ditë	15.07.2014-15.9.2014
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	22			